

27 qershor 2014 – Prizren

EC Ma Ndryshe organizoi vizitë informuese për qytetarët në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Në kuadër të projektit "Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë", EC Ma Ndryshe organizoi vizitën e parë për qytetarët në Gjykatën Themelore të Prizrenit me moton "Vizito gjykatën". Vizita në gjykatë kishte për qëllim të nxisë komunikim më të besueshëm ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve të Gjykatës Themelore në Prizren, duke i mundësuar qytetarëve njohjen e afërt me punën e gjykatës dhe të gjykatësve brenda departamenteve të ndryshme.

Vizitorët u pritën nga kryetari i Gjykatës Themelore, z. Ymer Hoxha dhe gjykatësi z. Skënder Çocaj.

Në pjesën e parë të vizitës, qytetarët panë nga afër objektin e gjykatës dhe morën informata mbi shërbimet që i ofron ky institucion për qytetarët e Prizrenit.

Pjesa e dytë përfshiu prezantimin e shkurtë të projektit dhe strategjisë së komunikimit të gjykatës me qytetarë, për të kaluar më pas në prezantimet e kryetarit mbi sfidat e punës, kapacitetet që ka gjykata. Po ashtu u hap diskutimi me pyetje dhe komente nga studentët, qytetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në takim u diskutuan çështje si qasja për PNV-të dhe mundësitë për gjykim të barabartë të PNV-ve në Gjykatën Themelore në Prizren, të rehat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësitë për takime të drejtpërdrejta me kryetarin e gjykatës dhe pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, sfidat e gjykatës dhe mundësitë e punës praktike për studentët e Fakultetit Juridik të UPz-së.

Projekti Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë përkrahet financiarisht nga USAID, mbikëqyret nga ATRC dhe zbatohet nga EC Ma Ndryshe. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në sektorin e drejtësisë dhe rritja e besimit në sistemin e drejtësisë.

Valon Xhabali, project coordinator
OJQ EC Ma Ndryshe
Perandori Dioklician 14 (kati V), 10000/Prishtinë
Saraqët 5, 20000/Prizren
038 224 967 & 029 222 771
044 250 818 & 049 250 818
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

Projekti Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë përkrahet financiarisht nga USAID, mbikëqyret nga ATRC dhe zbatohet nga EC Ma Ndryshe.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

